



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2540, datë 28.02.2015

Për

Shqyrtimin e Kërkesës Ankimore të Plus Communication sh.a. “Për anulimin e tenderit me objekt "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX" të miratuar me Vendimin e AKEP Nr.2527, datë 12.11.2014, si të pabazuar në ligj dhe rihapjen e procedurës së tenderit bazuar në legjislacionin në fuqi””.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | | |
|-----------------|----------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Anila | Denaj | Anëtar |
| 4. Znj. Ketrin | Topçiu | Anëtar |
| 5. Znj. Klarina | Allushi | Anëtar |

dhe sekretare znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 28.02.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimin e Kërkesës Ankimore të Plus Communication sh.a. “Për anulimin e tenderit me objekt "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX" të miratuar me Vendimin e AKEP Nr.2527, datë 12.11.2014, si të pabazuar në ligj dhe rihapjen e procedurës së tenderit bazuar në legjislacionin në fuqi””.

BAZA LIGJORE:

1. Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**), i ndryshuar;
2. Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**ligji nr. 8485**), i ndryshuar;
3. VKM nr.1252, datë 10.09.2008 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënie e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar,

4. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e Plus Communication sh.a. me nr. 228 Prot., datë 26.02.2015 (Prot. i AKEP nr. 499, datë 26.02.2015) me anë të së cilës ka paraqitur Kërkesën Ankimore për anulimin e tenderit me objekt "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WIMAX";
2. Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**), si dhe duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Plus Communication sh.a. me anë të shkresës me nr. 228 Prot., datë 26.02.2015 (Prot. i AKEP nr. 499, datë 26.02.2015) ka paraqitur kërkesën ankimore për anulimin e tenderit me objekt "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WIMAX".
2. Plus Communication sh.a. (Plus), citon se në vijim të:
 - a) Vendimit të AKEP Nr.2527, datë 12.11.2014 Për Miratimin e dokumentit të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sisteme GSM/LTE/UMTS/WiMAX"
 - b) Shkresave përkatëse sqaruese dërguar nga AKEP në datat 17-25 Shkurt 2015,
 - c) Pikës 9, Kreu III dhe Kreut IV të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1252 datë 10.09.2008, "Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave", i ndryshuar, si dhe
 - d) Pikës 6 dhe 16 te Kreut II të dokumentit të tenderit, paraqet kërkesën e tij ankimore për anulimin e këtij tenderi.
3. Plus Communication sh.a. (Plus), ka paraqitur argumentat e mëposhtme për të mbështetur kërkesën për anulimin e tenderit:
 - a) Kushtet e tenderit janë në kundërshtim me interesin publik për akses të barabartë të të gjithë operatorëve dhe pajtimtarëve të tyre në frekuencat e tenderuara. Mosmarrja e këtyre frekuencave e për rrjedhojë pamundësia e ofrimit të teknologjisë 4G nga operatorët e vegjël përbën diskriminim jo vetëm për operatorin PLUS, por së pari është në dëm të interesit publik, pasi shërbimet e teknologjisë 4G do të mund tu ofrohen vetëm pajtimtarëve me pozitë dominuese në treg dhe jo pajtimtarëve të operatorëve të vegjël, në një kohë kur përdorimi i teknologjive të reja është gjithnjë e më shumë një shërbim në rritje e mjaft i kërkuar nga pajtimtarët.
 - b) Kushtet e këtij tenderi janë në kundërshtim me Nenet 66, 68 pika 1 të Ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" si dhe Kreut I pika 1.1 të VKM nr.1252, datë 10.09.2008 "Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave",

pasi në bazë edhe të këshillimit publik kërkesat për caktim të frekuencave në një brez janë ishin më pak se frekuencat disponibël për t'u caktuar në këtë brez, dhe në këtë rast për dhënien e së drejtës për përdorimin e këtij brezi frekuencash nuk duhej të zbatohet procedura e tenderit publik. Konkretisht, në Vendimin Nr. 2495, datë 14.08.2014 për përfundimin e këshillimit publik jepen komentet e pjesëmarrësve të interesuar dhe shihet se ka vetëm 4 operatorë të interesuar për 6 autorizimet e tenderuara.

- c) Procedura e përzgjedhur për kryerjen e këtij tenderi është e pabazuar në ligj. Në Kreun II pika 1.1 të VKM nr.1252, jepen procedurat e parashikuara ligjore të kryerjes së tenderit publik dhe aty, nuk ka asnjë dispozitë që të parashikojë kryerjen e procesit me disa raunde dhe me dorëzimin e disa ofertave, duke sjellë për pasojë pabazueshmërinë në vetë Vendimin 1252 të kësaj procedure.
- d) Kushtet e tenderit janë në kundërshtim me dokumentin për këshillim publik miratuar me Vendimin nr. 2413, datë 27.01.2014.
AKEP ka parashikuar në këshillimin publik të dokumentit "Mbi përdorimin e brezave të frekuencave GSM 900/1800" miratuar me VKD nr.2413 datë 27.01.2014 dhe një riorganizim total të brezit 909-1800 MHz duke parashikuar dy skenarë të ridhënies në përdorim të brezit 900/1800 MHz, ku në thelb të secilit prej tyre ishte dhënia e kanaleve shtesë në brezin GSM 1800 për secilin nga të 4 operatorët celularë. Ndërkohë në kundërshtim me Ligjin nr.9918, Nenin 66 të tij dhe kushtet e dhëna në dokumentin për këshillim publik për këto të drejta përdorimi, të cilat parashikonin dhënien e këtyre të drejtave për të 4 operatorët celularë, në dokumentin e tenderit, siç konfirmohet edhe në shkresat sqaruese dërguar nga AKEP, parashikohen kushte diskriminuese për dhënien e këtyre të drejtave duke i dhënë mundësinë një operatori të marrë deri në 4 të drejta nga 6 të drejta të vëna në dispozicion, si dhe mundësinë e marrjes së brezave të paalokuar, skualifikimin e ofertave të vlerësuara nën 60 pikë, pavarësisht plotësimin të kriterëve të tenderit dhe çmimit të ofertës bazuar në vlerën e ofertës me çmimin më të madh etj.
- e) Baza ligjore për Vendimin nr. 2527, datë 12.11.2014 për Miratimin e dokumentit të Tenderit publik dhe konkretisht: Dokumenti - Nr. 3928 Prot., datë 21.10.2014, i Ministrisë për Inovacionin dhe Administratën Publike, "Kthim përgjigje shkresës Nr. 1559/4 Prot., datë 14.08.2014 si dhe Urdhëri Nr. 1314, datë 27.10.2014 "Për zhvillimin e tenderit publik për dhënien e Autorizimeve Individuale për përdorimin e frekuencave", nuk janë publikuar dhe nuk janë vënë në dispozicion të palëve të interesuara, në shkelje të parimit të transparencës në bazë të të cilës duhet të veprojnë organet e administratës publike.

Në përfundim të paraqitjes së argumentave, Plus, bazuar në pikën 9, Kreu III si dhe Kreun IV të VKM nr. 1252, kërkon:

- a. Anullimin e tenderit me objekt: "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WMAX", pasi dokumenti mbi të cilin do të kryhet ky tender është një dokument i pabazuar në ligj, si për sa i përket procedurës së tenderit të përzgjedhur, ashtu edhe për sa i përket shkeljes së parimeve thelbësore të ligjit nr. 9918 dhe kuadrit rregullator në fuqi për dhënien në përdorim të frekuencave bazuar në parimin e objektivitetit, transparencës, proporcionalitetit e mosdiskriminimit për t'u krijuar mundësinë të gjithë përdoruesve për të pasur përfitime maksimale nga aksesin në shërbimet e komunikimeve elektronike;

- b. **Rihapjen e procedurës së tenderit** bazuar në legjislacionin në fuqi në funksion të interesit publik për dhënien e aksesit të barabartë të gjithë operatorëve në frekuencat e tenderuara.

4. AKEP pasi ka shqyrtuar argumentet e Plus vlerëson se:

- a) Plus e nis ankimin e tij bazuar në Vendimin e AKEP Nr.2527, datë 12.11.2014 për Miratimin e dokumentit të Tenderit, shkresat përkatëse sqaruese dërguar nga AKEP në datat 17-25 Shkurt 2015, Pikën 9, Kreu III dhe Kreut IV të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1252 datë 10.09.2008, si dhe Pikës 6 dhe 16 të Kreut II të dokumentit të tenderit dhe kur paraqet objektin e ankimit citon si bazë ligjore **bazuar në pikën 9, Kreu III si dhe Kreun IV të VKM nr. 1252.**

Në zbatim të VKM nr. 1252, i ndryshuar, konkretisht në Kreun III, pika 9 “Anullimi i tenderit”, parashikohet e drejta e AKEP për anulimin e procedurës së tenderit. Qëllimi i përcaktimeve të nënpikave të pikës 9, është mundësia ligjore që i njihet AKEP që vetëm në rastin e cënimit apo mbrojtjes së interesit publik të bëjë anulimin e tenderit. Pra ushtrimi i të drejtës së AKEP për anulimin e tenderit është i lidhur me mbrojtjen e interesit publik dhe në respektim të parimeve të barazisë dhe transparencës. Në vijim të procedurave ligjore administrative që ka kryer AKEP, në asnjë rast nuk rezulton që të jetë cënuar ndonjë prej parimeve të së drejtës të parashikuara nga ligji dhe për më tepër të rezultojë të jetë cënuar apo rrezikuar mbrojtja e interesit publik, pasi të gjithë palëve të interesuara u është dhënë mundësia dhe aksesit për të marrë pjesë në këtë tender dhe të gjitha dokumentat e tenderit dhe procedurat e ndjekura nga data e publikimit të këtij tenderi janë transparente duke komunikuar me të gjitha palët e interesuara, duke dhënë sqarimet përkatëse në bazë të kërkesave të paraqitura nga operatorët e interesuar dhe ndërmjet tyre edhe PLUS Communication Sh.a. Në vazhdimësi të procesit të hartimit, miratimit dhe publikimit të dokumentacionit të tenderit, AKEP ka ndjekur me rigorozitet parashikimet dhe kërkesat ligjore.

- b) Referuar **VKM nr. 1252, i ndryshuar, Kreut IV** “ Procedurat e Rishikimit Administrativ”, pika 1, paragrafi 1.1 parashikohet se: “ *Shqyrtimi i ankesave të palëve që kanë interes në një procedurë tenderi publik dhe kur janë dëmtuar ose rrezikohen të dëmtohen nga një vendim i AKEP, që bie në kundërshtim me ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe këtë vendim, kryhet fillimisht nga AKEP dhe më pas nga Ministri i Inovacionit dhe Administratës Publike. Çdo ofertues mund të kërkojë rishikim administrativ të procesit të tenderit, kur gjykon se një vendim i AKEP është marrë në kundërshtim me këtë vendim, dhe paragrafi 1.2 - Ankesa paraqitet pranë Këshillit Drejtues të AKEP brenda 5 ditëve pune nga data kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij vendimi”.*

- c) Referuar sa më sipër jemi në kushtet e një procedure rishikimi administrativ. Aktualisht, AKEP është në kushtet kur nuk ka marrë asnjë Vendim administrativ ndaj të cilit çdo palë e interesuar do të kishte të drejtën ta kontestonte në kuptim të këtij Kreu. E vetmja vendimarrje e AKEP është Vendimi Nr.2527, datë 12.11.2014 “Për Miratimin e dokumentit të Tenderit publik me procedure të hapur me objekt: "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sisteme GSM/LTE/UMTS/WiMAX. Ndaj këtij Vendimi PLUS ka pasur dijeni të plotë (përfshirë Publikimin) dhe mund të ushtronte të drejtat e tij në përputhje me parashikimet e Kreut IV brenda 5 ditëve pune nga data kur u vu në dijeni për ekzistencën e tij. Në asnjë rast nuk ka pasur një ankim ndaj Vendimit të AKEP,

përveç se janë kërkuar në vazhdimësi sqarime për dokumentet e tenderit dhe për të cilat janë dhënë përgjigjet në rrugë shkresore rast pas rasti dhe në respektim të afateve ligjore. Në Kreun IV, përtej vendimarrjes së AKEP, i njihet e drejta çdo Ankimuesi që të mund të ushtrojë të drejtën e mëtejshme ankimore pranë Ministrit, i cili ka edhe të drejtën e pezullimit deri në përfundimin e shqyrtimit të ankimit. *Por, nga kërkesa ankimore e PLUS rezulton se pretendimet lidhen tërësisht me përmbajtjen e dokumenteve të tenderit, përgatitja dhe miratimi i të cilave ka ndjekur fazë pas fazë kërkesat ligjore e nënligjore.*

Tashmë është e qartë, që në kuptim të VKM, Pikës 6. “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit” janë përcaktuar saktësisht procedurat dhe afatet ligjore brenda të cilave duhet të paraqiten kërkesat për sqarime të dokumenteve të tenderit.

Në pikën 6.1 parashikohet*Ofertuesi i mundshëm (sipërmarrësi) mund të kërkojë sqarime nga AKEP, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo sipërmarrës, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.*

Bazuar në sa më sipër, Plus i ka lindur e drejta për ankimim ndaj një vendimi të AKEP që është marrë në kundërshtim me VKM 1252, i ndryshuar, dhe ta paraqesë atë brenda 5 ditëve pune nga data kur ankimuesi është vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar. Në argumentat e paraqitura nga Plus i vetmi vendim që atakohet është Vendimi i AKEP Nr.2527, datë 12.11.2014 për Miratimin e dokumentit të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sisteme GSM/LTE/UMTS/WiMAX". Ky vendim përveç publikimit në faqen elektronike të AKEP, është publikuar edhe në shtypin periodik të shkruar vendas, datë 25.11.2014 dhe atë të huaj.

Si përfundim “kërkesa ankimore për anulimin e tenderit” është në tejkalim të afateve ligjore të parashikuara në VKM si dhe në kapërcim të afateve kohore brenda të cilave kryhen procedurat e ankimit administrativ në përputhje me Ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative.

- d) Nga shyrtimi i materialit shkresor konstatohet se Plus si dhe gjithë të interesuarit e tjerë ka marrë të gjithë informacionin e duhur për këtë procedurë. Kështu përveç informacionit të publikuar në faqen elektronike të AKEP dhe në shtyp lidhur me këtë procedurë, Plus i janë dhënë sqarimet për të gjitha kërkesat e paraqitura duke respektuar konfidencialitetin e komunikimit dhe përpuethshmërinë me përcaktimet e VKM 1252, të ndryshuar, e Dokumentin e Tenderit. Referuar materialit shkresor, Plus i janë përcjellë nga AKEP edhe përmbledhja e të gjitha sqarimeve të dhëna për kërkesa të paraqitura nga të interesuarit e tjerë lidhur me këtë procedure.
- e) Argumenti se Dokumenti - Nr. 3928 Prot., datë 21.10.2014, i Ministrit për Inovacionin dhe Administratën Publike, "Kthim përgjigje shkresës Nr. 1559/4 Prot., datë 14.08.2014 si dhe Urdhëri Nr. 1314, datë 27.10.2014 nuk janë publikuar dhe nuk janë vënë në dispozicion të palëve të interesuara, në shkelje të parimit të transparencës në bazë të të cilës duhet të veprojnë organet e administratës publike nuk qëndron. Në lidhje me këtë pretendim sqarojmë se AKEP ka kryer gjithë procedurën ligjore në përputhje me:
- i. Nenin 20 “E drejta për tu informuar” parashikuar nga **ligji nr. 8485, i ndryshuar** “Kodi i Procedurës Administrative”;
 - ii. Parashikimet e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”
 - iii. Nenin 118 “Publikimi” të ligjit , 9918, i ndryshuar, “Për komunikimet elektronike në RSH”

Rezultoni se Plus ka pasur në dispozicion çdo mundësi aksesi në çdo lloj informacioni dhe dokumenti që është vënë në dispozicion nga AKEP në përputhje me parashikimet ligjore.

- f) Argumenti se procedurat e përcaktuara në Dokumentin e tenderit për mënyrën e vlerësimit të ofertave, mënyrën e organizimit të tenderit, numrin e të drejtave, etj. nuk qëndron pasi bazuar në përcaktimet e ligjit 9918, i ndryshuar, AKEP i ka propozuar Ministrin, në referim të nenit 68, pika 6 dhe është Ministri i cili në referim të pikës 7 të nenit 68, përfundimisht ka miratuar numrin e autorizimeve individuale, vlerën minimale për dhënien e tyre dhe ka nxjerr urdhërin për fillimin e konkurrimit publik, në përputhje me nenin 69 të këtij ligji. Pra konstatohet se parashikimet ligjore për përcaktimin e procedurës dhe hapat e njëpasnjëshëm janë ndjekur tërësisht dhe brenda afateve ligjore.
- g) Ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike me shkresën - Nr.3928 Prot., datë 21.10.2014, (Pro.t i AKEP: 1559/8, datë 24.10.2014), "Kthim përgjigje shkresës Nr.1559/4 Prot., datë 14.08.2014 "Dërgohet propozim për kufizimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave të brezit 1800MHz për sistemet (GSM/LTE/UMTS/WiMAX) procedurën e konkurrimit publik, numrin e autorizimeve individuale, kriteret e vlerësimit dhe çmimin minimal për dhënien e tyre " dhe shkresës Nr. 1559/7 Prot., datë 22.09.2014 "Përgjigje Tuajës me nr.3580 Prot. datë 19.09.2014" ka përcjellë në AKEP urdhërin për vijimin e procedurës ku midis të tjerash janë përcaktuar edhe kriteret e vlerësimit. Pas nxjerrjes së Urdhërit nga Ministri, AKEP cakton Njësinë e Hartimit të Dokumenteve dhe vijon procedurën me miratimin e dokumentit të tenderit.
- h) Argumenti se *kërkesat për caktim të frekuencave në një brez janë ishin me pak se frekuencat disponibël për t'u caktuar në këtë brez, dhe në këtë rast për dhënien e së drejtës për përdorimin e këtij brezi frekuencash nuk duhej të zbatohet procedura e tenderit publik*, kjo bazuar në këshillimin publik me palët nuk qëndron. Sasia e spektrit të lirë prej 36 MHz bazuar edhe në shpërndarjen faktike të tij teknikisht ishte zgjidhja më e pranueshme.
Së pari sepse ju krijohet mundësia të katër operatorëve përdorues të këtij spektri të mund të bëheshin pjesë e garës për të marrë të drejtë përdorimi dhe në kombinim me sasinë prej 9MHz që kanë aktualisht në përdorim të mund të ofronin shërbime të bazuar në sitemet e teknologjive të avancuara, LTE.
Së dyti, në këshillim publik interesi i paraqitur nga disa të interesuar ka qenë për sasi spektri deri në 20 MHz, që do të thotë deri në tre të drejta nga 6 MHz. Sasia e spektrit të lirë në dispozicion siç përmendet në argumentet e Plus nuk përcaktohet me numrin e të drejtave të përdorimit 6 por me sasinë e spektrit në dispozicion për tu dhënë në përdorim të interesuarve. Dhe pikërisht sasia e spektrit në dispozicion ka qenë e kufizuar për të plotësuar kërkesat e të interesuarve.
Së treti, në asnjë dokument AKEP nuk është shprehur se ky spektër është i destinuar vetëm për katër operatorët përdorues aktual të tij. Procedura ka parashikuar edhe pjesëmarrje në garë të interesuar të tjerë vendas dhe të huaj.
Së katërti, interesi për këtë brez varet shumë edhe në shfrytëzimin aktual të spektrit të dhënë në përdorim operatorëve. Plus, bazuar në të dhënat e raportuara e përdor shumë pak ose aspak spektrin e alokuar në brezin 1800 MHz.
Së pesti, spektri është një burim i fundëm dhe si i tillë ka edhe një vlerë ekonomike të caktuar cila është një element bazë në vlerësimin e tij.
- i) AKEP, gjithashtu konstaton se , Plus, me shkresën nr.196 prot. datë 20.02.2015 (Prot i AKEP 423/9 datë 23.02.2015) "Kërkesë për anulimin e tenderit me objekt "Dhënia

e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WIMAX", i është drejtuar Autoritetit të Konkurrencës, Ministrit për Inovacionin dhe Administratën Publike, AKEP dhe Kryetarit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave. Objekti i kërkesës për anulim dhe argumentat e sjella në kërkesë janë po ato që paraqiten në "Kërkesë Ankimore për anulimin e tenderit me objekt "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX", nr.228 datë 26.02.2015 (Prot. i AKEP nr. 499, datë 26.02.2015).

Nga sa më sipër, në vlerësim të të gjithë fakteve dhe argumentave, si dhe të gjithë procesit të ndjekur për hartimin dhe miratimin e dokumentit të këtij tenderi, nuk konstatohet asnjë shkelje e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1252, datë 10.09.2008 "Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave", të ndryshuar, apo akteve të tjera ligjore e nënligjore.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

1. Bazuar në të ligjin nr. 9918, i ndryshuar, Kodin e Procedurave Administrative, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1252, datë 10.09.2008 dhe Rregulloren e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP;

V E N D O S:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore të Plus Communication sh.a. depozituar në AKEP me anë të shkresës me nr.228 Prot., datë 26.02.2015 (Prot. i AKEP nr. 499, datë 26.02.2015).
2. Të njoftohet Plus Communication sh.a. për këtë Vendim;
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Anila DENAJ** _____
3. **Ketrin TOPÇIU** _____
4. **Klarina ALLUSHI** _____